ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: *Policia e Kosovës*

Për Aktivitetin e Prokurimit: *214-23-8647-1-1-1*

Sa i përket tenderit për *FURNIZIM ME UNIFORME POLICORE*

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

DE Kosova Tekstil L.L.C.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga Fehmi Agani Prishtinë
(Adresa)
Prishtinë
(Vendi)
(Kodi postar)
+38349333467
(Numri Telefonit)
(Numri i Faks-it)

Besfort Kapisyzi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
Besfort Kapisyzi
DEKosovatekstil@gmail.com
(Adresa elektronike)

SH. P. K. DE Kosova Tekstil PRISHTINË

16.04.2024
(Data e parashtrimit të kërkesës)
(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Isuf Zejna
(Emri i avokatit)

Rruga Fehmi Agani nr. 138/5 Prishtinë
(Adresa e plotë)

+38349287454
(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

Zejna@rzzlaw.com
(Adresa elektronike)

16.04.2024
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

FURNIZIM ME UNIFORME POLICORE

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] Jo [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Ne kemi dorëzuar ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, por i njëjti përkundër se i janë prezantuar argumente dhe prova të pakontestueshme, ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si kinse të pabazuar. Në anën tjetër në arsyetimin e vendimit, Autoriteti Kontraktues më shumë ka tentuar të na bindë ne se jemi të papërgjegjshëm, duke pretenduar se kemi mungesa të dokumentacionit, të cilat po të shihen në dokumentet e ofertës të gjitha janë të dorëzuara. Autoriteti kontraktues në anën tjetër nuk i ka trajtuar apo ka tentuar ti ikë pretendimeve tona në lidhje me mungesat e operatorit të rekomanduar për kontratë, duke i trajtuar të gjitha ato si devijime të vogla, e po të shihen në realitet janë devijime substanciale nga kërkesat e specifikave teknike dhe dosjes së tenderit.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji i Prokurimit Publik:

- Neni 1 – Qëllimi
- Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
- Neni 10 - Mjetet për promovimin e Transparencës
- Neni 11 - Informatat Sekrete Afariste
- Neni 13 - Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik
- Neni 52 - Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës
- Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 65 - Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve
- Neni 67 - Provat Shkresore
- Neni 68 - Gjendja Ekonomike dhe Financiare
- Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- Neni 70 - Standardet për Sigurimin e Cilësisë
- Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. HYRJE

1. Autoriteti Kontraktues Policia e Kosovës (Tutje referuar si: "Autoriteti Kontraktues") me datën 26.09.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë, për aktivitetin e prokurimit me titull: "*Furnizim me uniformë policore.*" Ky aktivitet i prokurimit ishte i ndarë në dy pjesë, përkatësisht pjesa 1. Furnizim me uniformë standarde policore dhe 2. Furnizim me uniformë solemne dhe të nderit për Policinë e Kosovës.

2. Brenda afatit të përcaktuar në Dosjen e tenderit dhe në përputhje me të gjitha kushtet e përcaktuar në dosje të tenderit, konsorciumi i operatorëve ekonomik në përbërje të: i) DE Kosova Tekstil ShPK, ii) D&E ShPK dhe iii) Kimay SRL (Tutje referuar si: "Ankuesi") kanë dorëzuar ofertën e tyre për këtë aktivitet të prokurimit.

3. Autoriteti Kontraktues me datën 26.12.2024 ka bërë hapjen e ofertave dhe leximin e çmimeve.

4. Me datë 25.03.2024 autoriteti kontraktues ka bërë publikimin e Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Në këtë Njoftim nuk janë përfshirë arsyet e eliminimit të ofertës së Ankuesit. Me datën 26.03.2024 Autoriteti kontraktues ka ri publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin ka përfshirë edhe arsyet e eliminimit të Ankuesit.

5. Në lidhje me Pjesën 1 të këtij aktiviteti të prokurimit, Autoriteti Kontraktues ka shpallur si ofertë të tenderuesit të suksesshëm grupin e operatorëve ekonomik EMPREUS ShPK, Seyntex dhe BOULEVARD ShPK (Tutje referuar si "Operatori i rekomanduar për kontratë").

6. Oferta e operatorit Ankues është shpallur sipas këtij njoftimi si e papërgjegjshme në pjesën e shqyrtimit të dokumentacionit për të dy pjesët me arsyet si në vazhdim:
   i) Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që qarkullimi i operatorëve ekonomik të dëshmohet me deklarata vjetore të dorëzuara në ATK, ndërsa operatori ka sjellur raporte të auditimit.

   ii) Atestet duhet të jenë nga laboratori i cili është i certifikuar sipas ISO 17025 2005. Së bashku me ateste duhet të dorëzohet edhe kopja e certifikatës ISO 17025 2005 e laboratorit ku është bërë testimi, atestet duhet të përmbajnë të dhënat e laboratorit, si numrin kontaktues, email, adresën elektronik. Atestet duhet të jenë në gjuhët zyrtare.

   iii) OE ka dështuar ta dëshmoj: OE ka dështuar Pantollonat e Verës dhe Pantollonat e Dimrit te uniforma standarde, Solemne dhe Nderit për M/F: Nuk ka atest të akredituar për ISO 7769. OE ka paraqitur një atest të cilin është bashkangjitur në ofertë në të cilin mungon llogo e akreditimit sikurse gjendet te atestet tjera. E kemi kontaktuar Laboratorin me datë 29.01.2024

ku kemi pytur lidhur me atestet e kryera në tre laboratorët. Kanë pranuar që i kanë kryer të gjitha atestet, duke përfshirë edhe dy ateste me numër 202308950 dhe 202308982 të cilat ju mungon llogo e akreditimit. AK e ka kontaktuar trupin akreditues me 31 janar 2024 dhe kanë kthyer përgjigje me datë 1 shkurt 2024. Ku përgjigjet që për këto dy ateste nuk janë lëshuar nder Accredia certifikata. E kemi kontaktuar përsëri Laboratorin Best Sri, Itali dhe përgjigja e tyre është: E përkthyer nga Anglisht: "Për sa i përket raporteve te standardit UNI EN ISO 6330:2012 + ISO 7769:2006, shenja ACCREDIA nuk tregohet sepse testi është kryer me 2 metoda: ISO 6330 për procedurën e larjes dhe ISO 7769 për vlerësimin e vetëm vizual të kampionit. ISO 6330 është i akredituar." Sipas emailit Laboratori nuk e pranon që për atestin ISO 7769 për vij të hekurit ka akreditirm. Andaj OE nuk I ka plotësuar kërkesat sipas Aneksit 1 të specifikacioneve teknike.

iv) Astari I Pantollonave te dimrit meshku/Femra, nuk ka atest të normës 3mm dhe për Qendrueshmeria e ngjyres pas larjes ne ne 30°CISO 105 C06 4, nuk ka atest dhe dëshmi se larja është bërë në 30°C.

7. Për arsyet e lartcekura Autoriteti Kontraktues pa kërkuar kurrfarë sqarime nga Ankuesi e ka eliminuar ofertën si të papërgjegjshme dhe nuk ka bërë fare hapjen e mostrave për verifikim dhe kontroll.

8. Ankuesi menjëherë ka kërkuar qasje në dokumente zyrtare për këtë aktivitet të prokurimit në të gjithë dokumentacionin e tenderit duke përfshirë ofertat e operatorëve ekonomik, raportin e vlerësimit të komisionit për vlerësimin e ofertave, të gjitha komunikimet e Autoritetit Kontraktues me operatorët ekonomik dhe të gjitha komunikimet e Autoritetit Kontraktues me laboratorët dhe trupat certifikiues/akreditues. Po ashtu është kërkuar edhe qasje në mostrat e operatorit të rekomanduar për dhënie të kontratës.

9. Autoriteti kontraktues, ka ofruar qasje të pjesshme në kundërshtim me Nenin 10 të Ligjit të Prokurimit Publik, duke mohuar qasjen në qarkullimin e operatorit të rekomanduar për dhënie, atestet për standardet e cilësisë, komunikimet e Autoritetit Kontraktues me këtë operator dhe komunikimet e Autoritetit Kontraktues me trupat certifikuese në lidhje me ISO standardet e këtij operatori ekonomik. Në lidhje me komunikimet e Autoritetit Kontraktues me operatorin ekonomik si dhe me trupat certifikuese, nuk ka pasur madje as kërkesë të këtij operatori për mbrojtje të sekretit afarist.

Propozim për nxjerrje të provës: *Ankuesi i propozon OSHP-së që të gjitha dokumentet e këtij tenderi t'i vejë në dispozicion të panelit, ekspertit si dhe ti ofrohen për ekzaminim Ankuesit në mënyrë që të vërtetoj pretendimet ankimore për mos përmbushje të kritereve të vlerësimit të ofertave.*

10. Autoriteti Kontraktues me datë 08.04.2024 ka publikuar Vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të Ankuesit, pa ofruar asnjë sqarim bindës dhe pa paraqitur prova mbi konstatimet e dhëna. Duke pas parasysh se Ankuesi nuk ka mjet tjetër në dispozicion për realizimin e të drejtave ligjore subjektive, me datë 16.04.2024 paraqet pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit këtë Ankesë, për të kërkuar Anulimin e Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues 25.03.2024 dhe të datës 26.03.2024 si dhe kthimin e lëndës në Rivlerësim.

II. OFERTA E ANKUESIT ËSHTË ELIMINUAR KUNDËRLIGJSHËM, NË KONSTATIM TË GABUAR TË GJENDJES FAKTIKE DHE APLIKIM TË GABUAR TË LIGJIT

11. Arsye e parë e eliminimit të ofertës së Ankuesit është për dëshmitë e qarkullimit. Në këtë kërkesë Autoriteti Kontraktues thotë se janë dorëzuar raportet e audituara financiare, pa dhënë asnjë konstatim tjetër sa i përket qarkullimit. Së pari duhet theksuar se dy nga tre anëtarët e konsorciumit në këtë aktivitet të prokurimit janë operator të huaj dhe qarkullimi nuk mund të bëhet me deklarata të ATK-së, siç pretendohet nga Autoriteti Kontraktues. Së dyti, raportet financiare të audituara janë tërësisht të pranueshme si dëshmi të qarkullimit financiar nga Ligji i Prokurimit Publik, përkatësisht Neni 68, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3, në të cilën raportet financiare të audituara përmenden shprehimisht si dokumente të pranueshme për dëshmi në lidhje me qarkullimin financiar.

12. Sidoqoftë edhe po të abstrahohet fakti se raportet financiare të audituara janë të mjaftueshme për të dëshmuar qarkullimin e operatorit ekonomik, përsëri konstatimi i Autoriteti Kontraktues është i gabuar, pasi që operatori ekonomik D&E ShPK ka dorëzuar edhe një dëshmi tjetër e cila është vërtetim i qarkullimit tre vjeçar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përkatësisht Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në të cilën dëshmohet se vetëm ky operator në tre vitet e fundit ka qarkullim prej: Viti 2020 - 692,893,189 lekësh, viti 2021 - 783,054,771 lekësh dhe viti 2022 - 946,113,194 lekësh. Nëse ky dokument do të ishte marrë në konsideratë, qarkullimi i këtij operatori do të kalonte vlerën 30 milion Euro për tre vite (konvertim me vlerën e lekut 1 EUR = 103.176 siç është kursi i këmbimit në ditën e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim). Autoriteti Kontraktues në Vendimin për Refuzim të kërkesës për rishqyrtim ka pranuar se ka gabuar në kalkulimin e vlerës së qarkullimit, duke tentuar të thotë se ishte vetëm një gabim teknik.

13. Prandaj, duke u bazuar në dëshmitë e dorëzuara me ofertë dhe vet konstatimin e Autoritetit Kontraktues në vendimin në lidhje me refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, vërehet qartë se ky konstatim është i gabuar nga ana e Komisionit Vlerësues dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, të cilët siç do të dëshmohet me këtë Ankesë, kanë shpikur arsye të paqena për eliminimin e ofertës së operatorit ankues. Autoriteti Kontraktues edhe po të kishte dilema për këtë çështje apo mungesa të tjera është dashur në përputhje me Nenin 72 të Ligjit të Prokurimit Publik të kërkoj sqarime, të cilat do ti ishin ofruar nga përfaqësuesit e Ankuesit.

14. Sa i përket arsyes së dytë të eliminimit në të cilën thuhet: "*Atestet duhet të jenë nga laboratori i cili është i certifikuar sipas ISO 17025 2005. Së bashku me ateste duhet të dorëzohet edhe kopja e certifikatës ISO 17025 2005 e laboratorit ku është bërë testimi, atestet duhet të përmbajnë të dhënat e laboratorit, si numrin kontaktues, email, adresën elektronik. Atestet duhet të jenë në gjuhët zyrtare.*" Ju konfirmojmë se të gjitha atestet kanë edhe akreditimin e theksuar në certifikatë, andaj ky konstatim se nuk është plotësuar ky kusht është i gabuar dhe mund të verifikohet nga hapja e cilitdo atest të dorëzuar, ku ekziston konfirmimi i akreditimit nga Accredia si dhe QR kodi i verifikimit të këtij informacioni. Për më tepër të gjitha testet janë nga laborator të Bashkimit Evropian siç kërkohet me nenin 70 të Ligjit të Prokurimit Publik, gjë e cila nuk mund të thuhet për ofertën e rekomanduar për dhënie të kontratës.

15. Sa i përket arsyes së tretë të eliminimit në Njoftim të Eliminimit thuhet: "*OE ka dështuar ta dëshmoj: OE ka dështuar Pantollonat e Verës dhe Pantollonat e Dimrit te uniforma standarde , Solemne dhe Nderit për M/F: Nuk ka atest të akredituar për ISO 7769. OE ka paraqitur një atest të cilin është bashkangjitur në ofertë në të cilin mungon llogo e akreditimit sikurse gjendet te atestet tjera. E kemi kontaktuar Laboratorin me datë 29.01.2024 ku kemi pytur lidhur me atestet e kryera në tre laboratorët. Kanë pranuar që i kanë kryer të gjitha atestet, duke përfshirë edhe dy ateste me numër 202308950 dhe 202308982 të cilat ju mungon llogo e akreditimit. AK e ka kontaktuar trupin akreditues me 31 janar 2024 dhe kanë kthyer përgjigje me datë 1 shkurt 2024. Ku përgjigjet që për këto dy ateste nuk janë lëshuar nder Accredia certifikata. E kemi kontaktuar përsëri Laboratorin Best Sri, Itali dhe përgjigja e tyre është: E përkthyer nga Anglisht:" Për sa i përket raporteve te standardit UNI EN ISO 6330:2012 + ISO 7769:2006, shenja ACCREDIA nuk tregohet sepse testi është kryer me 2 metoda: ISO 6330 për procedurën e larjes dhe ISO 7769 për vlerësimin e vetëm vizual të kampionit. ISO 6330 është i akredituar." Sipas emailit Laboratori nuk e pranon që për atestin ISO 7769 për vij të hekurit ka akreditirm. Andaj OE nuk I ka plotësuar kërkesat sipas Aneksit 1 të specifikacioneve teknike*". Fillimisht Ankuesi thekson se edhe ky testim është bërë nga Laboratori i certifikuar sipas kërkesave të dosjes së tenderit, dhe për të këtë çështje siç e ka theksuar edhe vet Autoriteti Kontraktues Laboratori ka ofruar sqarimet e duhura se testimi është bërë në dy metoda. Ky konstatim i Autoritetit kontraktues i cili e vë në pikëpyetje testimin e një Laboratori kredibil italian është tërësisht i pabazuar, pasi që për dallim nga Zyrtari përgjegjës i prokurimit në Autoritetin Kontraktues, Laboratoret në Bashkimin Evropian kanë përgjegjësi ligjore dhe morale për deklarimet e tyre të ofruara nga palëve të treta. Autoriteti Kontraktues nuk e ka dëshmuar në asnjë mënyrë se ky testim nuk është i pranueshëm në raport me kërkesat e dosjes së tenderit.

16. Falta ballore (angl.: Front pleat) - Një faltë, 3 cm poshtë shiritit të belit, duhet të jetë e pozicionuar në qendër të panelit ballor, një vijë hekuri e përhershme duhet të aplikohet dhe të jetë e qëndrueshme të paktën në 150 cikle të larjes ose larjes kimike. Me ofertë duhet dorëzuar edhe certifikata e cilësisë (për vijën e hekurit) ose Raporti i testimit nga një laborator i pavarur dhe i akredituar. Për sa i përket testit të vijës së hekurosjes pas 150 cikle larjesh është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues: "Me ofertë duhet dorëzuar edhe certifikata e cilësisë (për vijën e hekurit) ose Raporti i testimit nga një laborator i pavarur dhe i akredituar." Në këtë rast nuk kërkohet që Atesti ose metoda të jetë e akredituar, por vetëm laboratori të jetë i pavarur dhe akredituar. Prandaj Autoriteti kontraktues nuk mund të eliminoj ofertën tonë për kritere të cilat nuk kanë qenë pjesë e Dosjes së Tenderit. Megjithatë laboratori ynë metodën ISO 6330:2012 provën e larjes me 150 cikle e ka te akredituar me certifikatën 17025, por ISO 7769 nuk e ka te akredituar prandaj prova e analizës nuk paraqitet me logon Accredia. Ne specifikimet teknike është kërkuar që laboratori të jetë i akredituar dhe i pavarur. Autoriteti Kontraktues me këtë rast ka kryer shkelje të Nenit 52, paragrafi 3 në të cilën thuhet: "*Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës.*" Po ashtu Neni 70 përcakton: "*Autoriteti kontraktues do t'i pranojë certifikatat e barasvlershme të lëshuara nga cilido organ certifikues pavarësisht nga vendi, nëse organi i tillë pranohet nga një shtet anëtar i BE-së. Autoriteti kontraktues po ashtu pranon të dhënat e tjera të besueshme për masat e barasvlershme të sigurimit të cilësisë nga operatorët ekonomik që nuk kanë qasje ose mundësi për sigurimin e certifikatave të tilla brenda afateve të*

caktuara." Përderisa kërkesa është plotësuar me raporte të një Laboratori të akredituar italian dhe përderisa kjo certifikatë është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, Autoriteti Kontraktues nuk duhet të eliminoj ofertën tonë si kinse të papërgjegjshme, pasi që arsyeja e eliminimit nuk përputhet me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Në parim pra sipas Ligjit të Prokurimit Publik, kërkesa për informacione shtesë i bëhet operatorit i cili ka ofertuar në aktivitetin e prokurimi, e verifikimi i saktësisë apo vërtetësisë së informacioneve bëhet me trupat certifikuese. Përderisa Autoriteti Kontraktues i ka pyetur laboratorin dhe organin akreditues, i njëjti ka vepruar në kundërshtim me Ligjin, kur nuk na ka dhënë rastin që sipas Nenit 79 të ofrojmë sqarime për këtë situatë.

17. Në lidhje me arsyen e fundit të eliminimit në Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues thuhet se: Astari I Pantollonave te dimrit meshku/Femra, nuk ka atest të normës 3mm dhe për Qendrueshmeria e ngjyres pas larjes ne ne 30°CISO 105 C06 4, nuk ka atest dhe dëshmi se larja është bërë në 30°C. Fillimisht duhet theksuar se autoriteti kontraktues nuk ka kërkuar asnjë sqarim sa i përket kësaj çështje dhe po të kishte kërkuar do të merrte informacion të saktë. Atesti i dorëzuar nga Best Lab i datës 07.11.2023 i përmban të gjithë elementët e kërkuar në lidhje me testimin e ngjyrës, ndërsa standardi me të cilin është bërë testimi është në temperaturën 30°C pasi që si i tillë është kërkuar në dosjen e tenderit. Prandaj Autoriteti Kontraktues ka dështuar që të verifikoj drejtë gjendjen faktike sa i përket kësaj çështje, duke mos kërkuar sqarime. Në dosjen e tenderit është kërkuar: "Qëndrueshmëria e ngjyrës pas larjes ne 30 grade me ISO 105 C06 nota 4". Për këtë analizë theksojmë se nga ana jonë është paraqitur Atesti me nr: 202308415 i cili është bërë sipas parametrave të kërkuara në Dosjen e Tenderit. Kur Atesti kërkohet nga Autoriteti Kontraktues të bëhet në temperature 30 gradë automatikisht përgjigja e këtij Atesti është dhënë në 30 grade. Gjithsesi nëse AK kishte paqartësi duhet të përdorte nenin72 të Ligjit për të kërkuar sqarime. Po ashtu për metodën e testimit ka mundur që paralelisht të kërkohet informacion edhe nga laboratori.

III. OPERATORI I REKOMANDUAR PËR KONTRATË DO TË DUHEJ TË SHPALLEJ I PAPËRGJEGJSHËM

18. Nga qasja në dokumente dhe mostra të operatorit të rekomanduar për kontratë, kemi vërejtur se ky operator përveç se është më i shtrenjtë për nga vlera e ofertës, i njëjti edhe është dashur të shpallet i papërgjegjshëm për arsye se oferta e tij është e papërgjegjshme në kuptim administrativ dhe teknik të dokumentacionit. Arsyet e detajuara pse kjo ofertë do të duhej të shpallej e papërgjegjshme janë si në vazhdim:
    a. Në të gjitha atestet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues, Komisioni për hartimin e Specifikacioneve Teknike ka trajtuar dhe pranon Atestet të cilat nuk janë vetëm të viti 2023 (janë edhe të viteve paraprake). Përgjigja nga ana e AK është dhënë shumë papërcaktueshme (edhe të viteve paraprake) me vite paraprake nënkuptohet tenderi i mëparshëm i anuluar me nr. Prokurimi: 214-21-6003-1-1-1 i datës 25.11.2021 dhe jo ateste para kësaj date. OE Empreus ShPK & Seyntex dhe Boulevard ShPK ka paraqitur ateste shumë të vjetra (që nga viti 2017 deri ne vitin 2023), kjo është e papranueshme dhe në kundërshtim me çdo standard për vlefshmërinë e raporteve të testimit, të cilat nuk mund të kenë afat të pacaktuar skadimi. Atestet më të vjetra se tre vite duhet të jenë automatikisht të përjashtuara, pasi bien ndesh me standardet e testimeve dhe validitetit të certifikatave dhe

ato më të vjetra se një vit, duhet të verifikohen se a janë të vlefshme me Laboratorin që i ka lëshuar dhe organin akreditues. Për më tepër shumë ateste janë të njëdate të mëhershme sesa mostrat e prodhuara, në këtë rast këto ateste nuk mund të jenë të besueshme, pasi që nuk janë testuar mostrat e produktit të dorëzuara, por produkte të tjera të cilat nuk koorespondojnë me kohën dhe produktin e dorëzuar, andaj edhe Autoriteti Kontraktues duhet ta kishte sqaruar këtë situatë.

b. Nuk është dorëzuar certifikatë e inkorporimit me informacione të biznesit për operatorin Seyntex. Dokumenti i dorëzuar është Deklaratë e East Flanders Chamber of Commerce që është odë ekonomike dhe jo autoritet publik i regjistrimit të bizneseve në shtetin përkatës. Dokumenti i themelimit në dosje të tenderit është kërkuar: "Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit ose Numri Unik Identifikues". Prandaj ky kriter elementar nuk është plotësuar nga konsorciumi i rekomanduar. Në rast se në vendin përkatës të orgjinës nuk lëshohet një dokument i tillë siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit, operatori në fjalë është dashur të ofroj deklaratë nën betim së bashku me ofertën për të kompensuar mungesën e një dokumentacioni të tillë.

c. Ne referenca te Seyntex shkruan që kontratat nuk kanë përfunduar apo ësht e paqartë nga formati nëse ato janë përmbushur. Fillimisht, dy nga tre referencat janë më të vjetra se tre vite, andaj nuk mund të jenë të pranueshme. Referenca e tretë me Ministrinë e Mbrojtjes së Danimarkës në vlerë prej 13.076.295,76 Euro është 2017-2022. Autoriteti kontraktues duhet të verifikoj sasitë vetëm ato që janë pranuar në tre vitet e fundit, pasi që nuk mund të merren parasysh ato furnizime që janë bërë para kësaj periudhe. Në dosjen e tenderit kriteri ishte: "Per Pjesen 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te natyrës se njëjtë ose ngjashme profesionale si për shembull (uniforme Policore, uniforma Ushtarake, uniforma Zjarrfikëseve, uniforma Gardianeve, uniforma Doganierëve) gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e Korrigjimit te Njoftimit për kontratë) jo me pak se 5,000,000.00 €." Autoriteti Kontraktues nuk duhet të marrë në konsideratë referencat të cilat nuk kanë përfunduar, apo ato të cilat kanë përfunduar në një periudhë më të vjetër sesa tre vite nga inicimi i aktivitetit të prokurimit. Për këto referenca duhet të ofrohen edhe kontrata, fatura dhe dokumente të tjera që e bëjnë të besueshëm referencën, pasi që e njëjta nuk përmbanë asnjë element të sigurisë për tu verifikuar. Mungon llogo e institucionit, vula është po ashtu e dyshimt si dhe mungojnë kontaktet e personit i cili e ka lëshuar këtë referencë për të bërë verifikimet e nevojshme.

d. Laboratori United Testing Services (Jiangsu) është akredituar me 2023, ndërsa testimet e produkteve janë bërë në vitin 2022, pra para se ky laborator të jetë i certifikuar. Për më tepër ky laborator nuk është evropian dhe sipas Nenit 70 kjo certifikatë dhe të gjitha të tjerat të dorëzuara nga ky laborator nuk janë të pranueshme, pa u dëshmuar se kanë akreditim evropian apo se janë të pranueshme në BE.

e. Laboratori Intertek Testing Services Ltd., Shanghai është akredituar me 12/08/2022, ndërsa testimet e produkteve janë bërë në vitin 2021, pra para

se ky laborator të jetë i certifikuar (Produkti 9 i materiali i xhemperit). Po ashtu edhe ky laborator nuk është evropian nuk ka dëshmi se sipas Nenit 70 testet e këtij laboratori janë të pranueshme ne BE. Prandaj nuk mund të pranohet si certifikatë e vlefshme.

f. Materiali i pantallonave, është dorezuar atest nga kompania Supercrease mirëpo nuk kemi të dorëzuar certifikim të Supercrease.

g. ISO 9001 e prodhuesit Seyntex nuk është në gjuhët e lejuara sipas Ligjit të Prokurimit Publik, pasi që është në holandisht. Sipas Ligjit të Prokurimit Publik dokumentet pranohen në gjuhët zyrtare apo edhe gjuhën angleze, por jo edhe në gjuhët e tjera.

h. Pantallonat e verës, Diametri i fijeve të leshit ISO 137 21,5 μm (± 1 μm). OE ka ofertuar me vlerën 23.04 që është për më shumë 1 μm më e lartë. Cuklimi ISO 12945-1 Pas 18.000 cikleve: 4 – 5 Pas 36.000 cikleve: 4 - Rezultati ne test 4-5. Përbërja e materialit ISO 1833 53% Poliester (± 3%) 45% Lesh (± 3%), cuklim i ultë 2% Elastan. Rezultati ne test 2.2%. Rrjedhimisht është jashtë parametrave të lejuar dhe ofertën e bënë të papërgjegjshme.

i. Për produktin pantallona verë/dimër për femra/meshkuj është kërkuar një certifikatë cilësie ose një raport testimi nga një laborator i akredituar dhe i pavarur, ndërsa dokumenti i dorëzuar nga OE Empreus është një deklaratë e prodhuesit të materialit, pra nuk është as certifikatë cilësie e cila del nga një prodhues ku testi duhet të jetë nga një laborator i akredituar. Gjithashtu nuk është as një raport testim nga një laborator i akredituar dhe i pavarur. (Kjo deklaratë ka datën 15.10.2021, theksojmë se në këtë datë nuk ishte shpallur tenderi i mëparshëm me nr Prokurorimi: 214-21-6003-1-1-1 i datës 25.11.2021 dhe tender i dytë është shpallur në date 18.08.2023 me nr Prokurimi: 214-23-8647-1-1-1), andaj mbetet pikëpyetje se kujt i referohet një dokument i tillë!

j. Në specifikat e tenderit të kërkuara për artikullin Pantallonat e Verës/Dimrit për Femra/Meshkuj është kërkuar Trajtimi Final – Zmbrapes i ujit, vajrave dhe pluhurit, por OE nuk e ka deklaruar me atest këtë specifikë të kërkuar. (Për këtë specifikë në tenderin e mëparshëm është kërkuar Zmbrapsmeria ndaj vajit ISO 14419 dhe OE është skualifikuar pasi nuk e ka paraqitur këtë atest. Ndërsa këtë vit AK e ka kërkuar këtë specifikë: Trajtimi final (angl.: finish) Zmbrapës i ujit, vajrave dhe pluhurit. OE nuk ka paraqitur një deklarate apo Atest nga një laborator i akredituar. Gjithashtu tek përbërja e materialit në një nga specifikat e kërkuara kërkohet që këto produkte të jenë me cuklim të ulët. OE nuk e ka të deklaruar apo të testuar nga një laborator i akredituar këtë specifikë.

k. Këmisha me Mëngë të Shkurtra, Përbërja e materialit ISO 1833 60% Pambuk (± 3%), 40% Poliester (± 3%), trajtimi final ease care - Rezultatet 63% dhe 37%, rrjedhimisht në kundërshtim me specifikacionet teknike. Përdredhja e fijeve ISO 2061 70/1Nm (vertikal dhe hotrizontal) – Nuk ka fare testim. Në specifikat e tenderit të kërkuara për artikullin Këmishë me mëngë të shkurtra për Femra/Meshkuj është kërkuar Trajtimi Final – easy care, por OE nuk e ka deklaruar me atest këtë specifikë të kërkuar.

l. Këmisha me Mëngë të Gjata, Përdredhja e fijeve ISO 2061 - 70/1Nm (vertikal dhe hotrizontal) – Nuk ka testim.

m. Kravata, Masa/ njësi gjatësie ISO 7211/5, Vertikal: 85dtex (±3%) - Rezutati 80.5 (5.3% me i ulet). Horizontal: 120dtex (±3%) – Rez 109.3 (8.9% më i ulët).

n. Kapela e punës Femra/Meshkuj - Në specifikat e tenderit të kërkuara për artikullin Kapele e punës për Femra/Meshkuj është kërkuar Trajtimi Final – Zmbrapes i ujit, vajrave dhe pluhurit, por OE nuk e ka deklaruar me atest këtë specifik të kërkuar. (Për këtë specifikë në tenderin e mëparshëm është kërkuar Zmbrapsmeria ndaj vajit ISO 14419 dhe OE është skualifikuar pasi nuk e ka paraqitur këtë atest. Ndërsa këtë vit AK e ka kërkuar këtë specifikë: Trajtimi final (angl.: finish)Zmbrapës i ujit, vajrave dhe pluhurit. OE nuk ka paraqitur një deklaratë apo Atest nga një laborator i akredituar se i plotëson kriteret siç janë kërkuar në dosjen e tenderit.

o. Në specifikat e kërkuara për artikullin Kapele e punës për femra specifikimet teknike tregojnë qartë dy specifika të kërkuara për sa i përket Shiritit të brendshëm të brinjëzuar dhe Materialit jo të endur. Shiriti i brendshëm i brinjëzuar. Shiriti i brendshëm i brinjëzuar duhet të jetë Poliester 100% me gjerësi 2,5 cm Materiali jo i endur - Viskozë 35 gram / m² ose ekuivalente. Operatori i rekomanduar nuk ka paraqitur Atest për këto specifika te këtyre dy pikave të lartpërmendura.

p. Jakna e dimrit Femra/Meshkuj - Për artikullin Jakna e dimrit për Femra/Meshkuj është kërkuar specifika e mëposhtme për Astarin e Jaknes së dimrit. Jakna duhet të jetë e pajisur plotësisht (deri në mansheta) me një astar të mbushur me tegela. Astari në pjesën e trupit duet të jetë me peshë 160 g/m2, RCT Izolim Termik sipas DIN EN 31092/ISO 11092: 0.32 kurse në pjesën e mëngëve 80 g/m2 RCT Izolim Termik sipas DIN EN 31092/ISO 11092: 0.20. Astari duhet të jetë i fiksuar përhershëm për jakne. Etiketa e prodhuesit me të dhëna duhet të jetë e qepur nën jakë në qendër të shpinës. OE nuk ka paraqitur Atest për këtë specifik te kërkuar të Astari i Jaknes së Dimrit për Femra/Meshkuj. Atestet e paraqitura nga OE janë vetëm për Jaken e Veres. Në Atestet e paraqitura të kryera nga laboratorët përkatës tregohet qartë që Atesti është vetëm për Jaknen e Verës. OE nuk ka paraqitur Atest për Jaknen e Dimrit.

q. Kravata për Femra/Meshkuj - Në parametrat e kërkuar në specifikat e Dosjes së Tenderit për artikullin kravata është kërkuar: Masa/njësi gjatësie ISO 7211/5 - Vertikal: 85dtex (±3%) - Horizontal: 120 dtex (±3%). Parametrat e ofruar janë: Vertikal: 80.5 dtex - Horizontal: 109.5 dtex. OE nuk i përmbush specifikat teknike për këtë artikull.

r. Në procedurën e mëparshme për këtë specifikë të artikullit Kravata për Femra/Meshkuj, specifikat e kërkuara kanë qenë të njëjta me procedurën aktuale. Ne procedurën e mëparshme AK në një nga arsyetimet e skualifikimit për OE e ka cituar që kjo specifikë me parametrat e ofruara nga OE nuk i përmbush specfikimet teknike të detyrueshme, ndërsa këtë vit me po të njëjtin Atest Autoriteti Kontraktues tenton ta shpërblen me kontratë.

s. Xhemper për Femra/Meshkuj - Atesti i paraqitur nga Laboratori Intertek nuk tregon asnjë standard me të cilin është kryer testimi për këtë specifikë të artikullit Xhemper. Në specifikat teknike është kërkuar: Endja ISO 2060/72 Half Milano. OE nuk e ka paraqitur në Atest se me cilën metodë është kryer ky testim. Duke i shtuar këtu edhe mungesat sipas neni 70 të Ligjit ky atest është i papranueshëm.

19. Përveç mungesa në dokumentacion, nga qasja në mostrat e produkteve vërehet se operatori po ashtu nuk plotëson kriteret dhe specifikacionet e tenderit edhe nga mostrat e dorëzuara, për arsyet që do të sqarohen në vijim:

a. Përmasat në stemën e flamurit shtetëror të Kosovës (shenjë krahu) nuk përputhen me specifikimet teknike të dokumenteve të tenderit. Përmasat kërkohen 80mm me 50mm ndërsa mostrat e dorëzuara janë në përmasat 75mm me 48mm, ky devijim është substancial me kërkesat e dosjes.

b. Kopsat në këmisha që janë kërkuar me mbishkrimin "POLICE KOSOVO", rezultuan të jenë me mbishkrimin "KOSOVO POLICE", sikurse kanë qenë në uniformat e vjetra.

c. Artikujt "jakna e dimrit" (meshkuj-femra) dhe "jakna e verës" (meshkuj-femra), na rezultoi se janë me dy shtresa dhe jo me tre siç kërkohen në specifikimet teknike. Kjo e metë e mostrave nuk është identifikuar nga komisioni dhe si e tillë do të duhej që Autoritetit Kontraktues ti shërbejë si arsye për eliminim oferte.

d. Në artikujt "jakna e dimrit", "jakna e verës" (meshkuj-femra), shiritat për spaleta rezultojnë me përmasat 15cm x 4cm, nga 13.5cm x 4cm, siç përcaktohet në specifikimet teknike.

e. Në artikullin "jakna e verës" për meshkuj, nga matjet e kryera për masën L-Regular, rezulton se 1/2-ta e gjoksit 58cm nga 63cm që kërkohet në specifikimet teknike.

f. Në artikujt "pantallona vere" (meshkuj-femra), "pantallona dimri" (meshkuj-femra), nuk është aplikur shiriti i fortë prej najloni në pjesën e poshtme të këmbës së pantallonave, siç kërkon specifikimi Teknik.

g. Artikulli kravatë për meshkuj rezulton me gjatësi 45cm dhe jo 47 cm siç kërkon specifikimi teknik.

h. Në artikullin "këmishë me mëngë të shkurtra", për meshkuj, nga matjet e bëra në masën 42, rezultoi se masa e 1/2-tës së gjoksit është 60 cm dhe jo 62cm sipas specifikimit teknik. Ndërsa gjerësia prapa në tegelin e supeve është 48 cm dhe jo 49cm, siç kërkohet ne specifikimin teknik.

i. Në artikullin "këmishë me mëngë të gjatë", për meshkuj, simbolet e krahut janë të vendosura 55mm poshtë supit dhe jo 70 mm sipas specifikimit teknik.

j. Në të gjithë artikujt e paraqitur nga kompania e kualifikuar për tenderin në fjalë, etiketat shënojnë vitin e prodhimit 2021.

20. Konkluzion për mostrat: Nga parashtrimi i më sipërm rezulton se në mostrat fizike të paraqitura (të prodhimit të vitit 2021), nuk janë reflektuar ndryshimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues në këtë tender si dhe atestet me mostra nuk përkojnë në datat e testimit dhe të prodhimit.

21. Po ashtu kemi dyshim të bazuar se arsye e mos ofrimit të komunikimeve nga ana e Prokurimit me laboratorët dhe trupat certifikuese është fakti se disa certifikata të operatorit të rekomanduar për kontratë kanë rezultuar falce dhe me të dhëna të pasakta.

22. Vlen të thuhet se të gjitha këto pretendime kanë qenë në dispozicion të autoritetit kontraktues dhe i njëjti ka vendosur ti injoroj që të gjitha këto mungesa të ofertës së rekomanduar për kontratë. Sa i përket gjuhës në procedurë të prokurimit sipas Nenit 13 dokumentet mund të dorëzohen në gjuhë zyrtare apo në Anglisht, operatori i rekomanduar ka dorëzuar në gjuhën holandeze ISO certifikatën. Sa i përket akreditimit të laboratorit, sipas Nenit 70 thuhet: "*Autoriteti kontraktues do t'i pranojë certifikatat e barasvlershme të lëshuara nga cilido organ certifikues pavarësisht nga vendi, nëse organi i tillë pranohet nga një shtet anëtar i BE-së. Autoriteti kontraktues po ashtu pranon të dhënat e tjera të besueshme për masat e barasvlershme të sigurimit të cilësisë nga operatorët ekonomik që nuk kanë qasje ose mundësi për sigurimin e certifikatave të tilla brenda afateve të caktuara.*" Në rastin konkret këto certifikata janë të papraneshme përshkak të origjinës së tyre e cila nuk i përket asnjë shteti anëtarë të BE-së. Po ashtu edhe me Nenin 62 të Direktivës së BE-së për Prokurimin Publik 2014/24, certifikatat dhe raportet e testimit pranohen vetëm nga laboratorët e BE-së.

Prandaj, duke marrë në konsideratë të gjitha arsyet e lartcekura, me respekt i kërkojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit, që pas shqyrtimit të kësaj Ankese të nxjerr këtë:

VENDIM

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar Ankesa e konsorciumit DE Kosova Tekstil ShPK, D&E ShPK dhe Kimay SRL të cilën sipas Autorizimit e përfaqëson Avokati Isuf Zejna me seli në Rrugën Fehmi Agani Nr. 138/5, kurse Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 25.03.2024 dhe ai i datës 26.03.2024 ANULOHEN, dhe lënda i kthehet Autoritetit Kontraktues në RIVLERËSIM.

II. DETYROHET që në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

III. LEJOHET të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*